



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 188/6 prot.

Tiranë, më 3.5.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 730, datë 10.1.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Valentin Preçi
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 23.4.2024, është njoftuar vendimi nr. 730, datë 10.1.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Valentin Preçi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 24.4.2024, është depozituar akti: “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nr. 160/1 prot., datë 23.4.2024¹, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, datë 24.4.2024, ushtron ankim ndaj vendimit nr. 730, datë 10.1.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

¹ Protokolluar pranë IKP-së me nr.188/2 prot., datë 24.4.2024.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Valentin Preçi, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë dhe, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1² e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Valentin Preçi, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si *ILDKPKI*), Raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si *DSIK*) dhe Raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si *KLP*), nga të cilat rezulton se:

2.1 *ILDKPKI*, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Valentin Preçi”³ ka referuar se:

- i. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 *DSIK*, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të Raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Valentin Preçi⁴, ka referuar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Valentin *** Preçi”.

2.3 *KLP*, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin⁵ për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Valentin Preçi.

3. Në datën 21.11.2023, Komisioni i dërgoi subjektit rezultatet e hetimit administrativ për sjelljen e provave dhe shpjegimeve për të provuar të kundërtën e barrës së provës, deri në datën 5.12.2023. Me vendimin nr. **, të datës 26.12.2023, Komisioni vendosi të riçelë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, për shkak të administrimit të denoncimeve të reja, si dhe disa qartësimeve e saktësimeve të mëtejshme në lidhje me pretendimet e tij për rishikimin e analizës financiare, duke i dhënë subjektit një afat për dërgimin e parashtrimeve deri në datën 5.1.2024. Me vendimin nr. **, të datës 5.1.2024, Komisioni vendosi të mbyllë hetimin administrativ dhe të thërrasë në seancë dëgjimore subjektin e rivlerësimit në datën 9.1.2024.

² Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

³ Shkresa e *ILDKPKI*-së me nr. ***/** prot., datë **.10.2018.

⁴ Shkresa e *DSIK*-së nr. *** prot., datë **.11.2017. Deklasifikuar me vendim të KDZH-së nr. ***, datë **.7.2020.

⁵ Raport i *KLP*-së nr. *** prot., datë **.5.2023.

4. Në përfundim të hetimit administrativ shtesë, Komisioni, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar si vijon:

4.1 Për vlerësimin e pasurisë. [...] Në respektim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, referuar fakteve e rrethanave si vijojnë: (i) vlera -1.241.068 lekë shpërndahet në disa vite në vlera jo domethënëse; (ii) e gjithë pasuria e subjektit dhe bashkëshortes përbëhet nga një apartament dhe një autoveturë dhe nuk u vërtetuan përpjekje të subjektit për të fshehur apo për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në posedim ose në përdorimin e tij; (iii) nuk u evidentuan transaksione të dyshimta në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij, të cilat mund të vinin në dyshim burimet e pasurive dhe shpenzimet e çdo lloji; (iv) gjatë vlerësimit të kriterit të figurës nuk ka pasur të dhëna apo dyshime për veprimtari të kundërligjshme të subjektit, që mund të vinin në dyshim burimin e të ardhurave për krijimin e pasurive, nga Komisioni vlerësohet se balanca negative prej -1.241.068 lekësh nuk mund të shërbejë si shkak për të vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 [...] ⁶.

4.2 Për kontrollin e figurës. [...] Komisioni, pas hetimit të kryer në lidhje me këtë kriter, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Valentin Preçi ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës [...] ⁷.

4.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. [...] Komisioni nuk i çmoi problematikat e evidentuara dhe të trajtuara hollësisht në këtë vendim si shkaqe që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të germës “e” të aneksit të Kushtetutës, apo që ta bëjnë atë të papërshtatshëm në drejtim të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, sipas shkronjës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...] ⁸.

5. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 51, shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 58, dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash, ka vendosur: [...]. 1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Valentin Preçi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë [...].

⁶ Referohuni prg. 57.1, faqe 54 e vendimit.

⁷ Referohuni prg. 58.4, faqe 55 e vendimit.

⁸ Referohuni prg. 76, faqe 85 e vendimit.

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

6. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”⁹ e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2¹⁰ e ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 24.4.2024, ka depozituar pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë aktin “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 730, datë 10.1.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Valentin Preçi (bashkëlidhur këtij ankimi).

6.1 Në pikën 2: “Arsyet e rekomandimit”, Komisioni prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, ndër të tjera¹¹, ka referuar se: [...]

6.1.1 *Opinioni i vëzhguesve ndërkombëtarë është se subjekti i vlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës në lidhje me disa gjetje thelbësore të rezultuara nga hetimi. Gjithashtu, vërehet se përpjekjet e subjektit të vlerësimit për të kundërshtuar këto gjetje ishin kryesisht të bazuar në deklarime/shpjegime të pambështetura në prova. Megjithatë, Komisioni pranoi të gjitha shpjegimet e tij dhe vendosi të konfirmonte subjektin e vlerësimit në detyrë, me shumicë votash.*

6.1.2 *Vëzhguesit Ndërkombëtarë besojnë se një vlerësim i duhur i provave në rastin konkret, së bashku me zbatimin e saktë të bazës ligjore të aplikueshme, i jep mundësinë Kolegjit të ndryshojë vendimin e Komisionit, në përputhje me nenin 66, paragrafi 1/c të ligjit të Vettingut [...].*

6.1.3 Në mënyrë të përmbledhur, vëzhguesit ndërkombëtarë kërkojnë një vlerësim gjyqësor tërësor të rastit, duke u përqendruar veçanërisht në çështjet e mëposhtme:

6.2 *Për kriterin e pasurisë: (1) Mbulimi/financimi i shpenzimeve të kredisë nga vjehri ***; (2) Shpenzimet e udhëtimit (transporti dhe qëndrimi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës); (3) Ndihma sociale e marrë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës; si dhe (4) Të ardhurat e përfituara nga lotot sportive.*

6.3 *Për kriterin e figurës: (1) Analiza e sjelljes etike kërkon një vlerësim të një standardi më të lartë të detajuar, duke konsideruar jo vetëm sjelljen e subjektit të vlerësimit, por edhe si mund ta perceptojë atë sjellje një vëzhgues i jashtëm.*

6.4 *Për kriterin e aftësive profesionale: (1) Etika: nëse kontaktet e rezultuara nuk u vlerësuan si të papërshtatshme në vlerësimin e kriterit të figurës, atëherë një analizë e veçantë duhet të kryhet për qëllime etike në vlerësimin e kriterit të aftësisë profesionale, në vlerësim tërësor të rastit; (2) Konflikti i interesit; (3) Dy nga denoncimet, konkretisht të shtetasve ***. ***. dhe ***. ***.*

⁹ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra: [...] u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit [...].

¹⁰ Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë t'i paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

¹¹ [...] Disa çështje nuk u vlerësuan në mënyrë të duhur nga Komisioni, çka e bën vendimmarrjen të paqartë. Nuk duket që vendimi të bazohet në provat e disponueshme. Ai devijon nga standardet e zakonshme të mbajtura nga Komisioni në praktikën e tij aktuale, dhe nga parimet dhe udhëzimet e vendosura nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit [...].

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

7. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

8. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

9. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

10. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 730/2024, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, të datës 23.4.2024, çmon se ai është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

11. Për sa më sipër, Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 730/2024, të Komisionit, në tërësinë e tij.

Analiza e shkaqeve të ankimit

IV. A. Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

12. Për pasuritë “Apartament banimi me sipërfaqe 84,54 m²” dhe “Garazh me sipërfaqe 14 m²”, ndodhur në ***, Tiranë

12.1 Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: Apartament banimi me sip. 84,54 m² dhe garazh me sip. 14 m², me çmim total blerje 50.000 euro, me adresë: Rruga *** ***, ***, Tiranë. *Burimi i krimit:* Kredi hipotekore dhe konsumatore, e para me vlerë 24.500 euro, sipas kontratës së huas me nr. rep. *** dhe kol. ***, dt. **.3.2008, si dhe e dyta me vlerë 5.500 euro, sipas kontratës së huas, datë **.3.2008, të marra nga banka ***, sot *** Bank. Diferenca prej 20.000 euro është paguar me para në dorë e ndarë në 3 këste (respektivisht 10.000 euro në 2008, 5.000 euro në vitin 2011, 5.000 euro në vitin 2014), nga kursimet e familjes. Shuma prej 5.000 euro, e shlyer në vitin 2011, është paguar për llogarinë time nga kunati im, *** *** dhe i është shlyer atij prej meje me anë të kursimeve të familjes në vitin 2012. *Vlera:* 50.000 euro. *Pjesa takuese:* 100%.

12.2 Në DV-2008, subjekti ka deklaruar si adresë banimi/regjistrimi në gjendjen civile këtë apartament, gjithashtu në rubrikën: “Ndryshim të interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar apartamentin me sipërfaqe ndërtimi 90,8 m², ***, Tiranë, me kontratë sipërmarrje nr. *** rep. dhe ***/* kol., datë **.1.2009, i pahipotekuar, në shumën 50.000 euro, me pjesë takuese 100%. Burimi i krijimit: 2 kredi në *** Bank, në shumën totale 30.000 euro + 1.250.000 lekë, nga gjendja *cash* e deklaruar më parë, konvertuar në euro. Shlyer firmës ndërtuese deri në **.12.2008, shuma 40.000 euro dhe detyrimi i mbetur ndaj firmës, në shumën prej 10.000 euro. Pakësuar gjendja *cash* e deklaruar më parë, përdorur për blerje apartamenti shuma 1.250.000 lekë.

12.3 Në DV-2009 dhe DV-2010, subjekti nuk ka deklaruar ndryshime në lidhje me këtë pasuri, por në këto vite janë pasqyruar vetëm detyrimet përkatëse financiare ndaj Bankës *** për huat /kreditë e marra në vitin 2008.

12.4 Në DV-2011, subjekti ka deklaruar, ndër të tjera: [...] shlyer detyrim ndaj firmës së ndërtimit *** ***, në shumën 5.000 euro. Kjo shumë është shlyer nga vetë kunati im, me mandat arkëtimi nr. **, datë **.8.2011 (detyrim i mbetur shuma 5.000 euro) [...]. Ndërsa në rubrikën: “Të dhëna konfidenciale (dhurata dhe trajtime preferenciale)”, subjekti ka deklaruar: [...] Detyrim kunatit, *** ***, në shumën 5.000 euro, i cili, në datën **.8.2011, ka arkëtuar për llogarinë time shlyerje detyrimi me mandat pagese ndaj firmës së ndërtimit së cilës i kam blerë apartamentin [...].

12.5 Në DV-2014, subjekti ka deklaruar regjistrimin në ZVRPP Tiranë, në datën **.9.2014, të pasurisë “apartamenti + garazh”, porositur te shoqëria “**** ***” sh.p.k., me kontratë sipërmarrje datë **.1.2009 dhe likuiduar pjesa e mbetur nga detyrimi ndaj shoqërisë ndërtimore, në vlerë 5.000 euro.

12.6 Komisioni, me aktin “Rezultate të hetimit administrativ ...”, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës për këtë pasuri, pasi ka konstatuar se: [...] Duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur mundësi financiare për: (i) pagesën e shumës prej 40.000 euro, në vitin 2008 (balanca negative paraprake në vlerën -1.336.380 lekë); (ii) pagesën e këstit 5.000 euro, në vitin 2011 (balanca negative paraprake në vlerën -1.384.679 lekë)¹²; (iii) pagesën e këstit të fundit, në vlerën 5.000 euro, në datën 26.9.2014 (balanca negative paraprake në vlerë -93.965 lekë) [...].

12.7 Subjekti i rivlerësimit, në prapësime të rezultateve të hetimit administrativ, ka kundërshtuar zërat e analizës financiare të kryer nga Komisioni, në mënyrë të përmbledhur lidhur me: (i) Destinacionin e kredisë konsumatore përfituar nga *** Bank (sot *** Bank), në vlerën 4.950 euro dhe shumës së tërhequr prej saj, duke pretenduar se ajo është përdorur si pjesë e pagesës së këstit të apartamentit, paguar në vitin 2008; (ii) Konsiderimin si të ardhura të ligjshme dhe përfshirjen në analizën financiare për vitin 2008 të të ardhurave të deklaruara nga punësimi i bashkëshortes nga shoqëria “**** ***”, duke pretenduar mungesën e dijenisë dhe mospasjen përgjegjësi për mospagimin e detyrimeve tatimore dhe kontributeve nga ish-punëdhënësi i bashkëshortes, si dhe faktin se gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 32,

¹² Shtetasi *** *** duket se nuk ka arritur të dokumentojë burimin e të ardhurave për shumën prej 5.000 euro, të paguara si huadhënie për këstin e çmimit të blerjes së apartamentit, në datën **.8.2011, për rrjedhojë, kjo shumë nuk pasqyrohet si e ardhur në analizën paraprake financiare në lidhje me këtë pasuri të paluajtshme.

pika 2 e ligjit 84/2016; (iii) Mbulimin/financimin nga babai i bashkëshortes i shlyerjes së disa kësteve të kredisë për vitet 2008-2010, si dhe të disa shpenzimeve të udhëtimit të subjektit dhe të bashkëshortes në SHBA; (iv) Rishikimin e të ardhurave të bashkëshortes nga rimbursimi nga taksat në SHBA dhe asistenca për vitet e marra në analizë, si dhe rishikimin e shpenzimeve të qëndrimit dhe jetesës në SHBA, duke pretenduar, ndër të tjera, dhe mbulimin e shpenzimeve për akomodim dhe ushqim nga persona të tretë; (v) Përfshirjen në analizën financiare, për vitin 2011, e vlerës së huas prej 5.000 euro, nga personi tjetër i lidhur, *** ***, (vi) Rishikimin e analizës financiare në lidhje me likuiditetet *cash* ndër vite; si dhe (vii) Rishikimin e shpenzimeve të telefonit për të shmangur dublikimet.

12.8 Komisioni ka vlerësuar, në mënyrë të përmbledhur, se: [...] *Në lidhje me shumën e përfituar si kredi konsumatore në vlerën 5.500 euro dhe tërhequr cash nga subjekti nga llogaria bankare, në përfundim të procesit, Komisioni i çmoi bindëse pretendimet e subjektit të rivlerësimit si të bazuara në ligj dhe në prova. Për rrjedhojë, vlerësoi se, pavarësisht se kredia e dytë formalisht është marrë me qëllim mobilimi, është vërtetuar se kjo kredi, pasi është tërhequr nga subjekti, është përdorur për pagimin e një pjese të çmimit të shitjes së pasurisë objekt verifikimi.¹³...Në lidhje me të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes gjatë viteve 2008 dhe 2009, në analizë të të gjitha parashtrimeve dhe dokumenteve shkresore të administruara gjatë hetimit dhe pas kalimit të barrës së provës, Komisioni vlerësoi të bazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit, duke i konsideruar të ardhurat nga paga e bashkëshortes si të ligjshme, bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 84/2016, neni D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe orientimit të Kolegjit¹⁴...Në lidhje me financimin e shpenzimeve të kredisë nga vjehtëri *** ***, në analizë të të gjitha parashtrimeve dhe dokumenteve që subjekti ka paraqitur, si dhe qëndrimit të mbajtur në Kolegj/Komision në raste të ngjashme, në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi që, në analizën financiare të rishikuar, këstet për pagimin e kredisë të mos konsiderohen si shpenzime të subjektit, për sa kohë: (i) këto pagesa të kryera nga vjehtëri i tij janë deklaruar që në përgjigje të pyetësorit standard; (ii) bazuar në dokumentacionin ligjor të depozituar nuk mund të konkludohet që familja e bashkëshortes nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për pagesat e kësteve të kredisë¹⁵...Në lidhje me pretendimet e subjektit mbi rishikimin e analizës financiare dhe korrigjimin e shpenzimeve të jetesës në SHBA, në përfundim të procesit, në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve shkresore që subjekti ka paraqitur, Komisioni vlerësoi se subjekti ka argumentuar bindshëm pretendimet e tij në lidhje me shpenzimet e jetesës në Amerikë, duke përfshirë këto shpenzime në analizën financiare të rishikuar sipas përlllogaritjeve të subjektit të rivlerësimit¹⁶...Në lidhje me burimin e të ardhurave për pagesën e shumës 5.000 euro nga personi tjetër i lidhur, ***. ***, Komisioni vlerëson të konsiderojë të bazuara argumentet e subjektit të rivlerësimit, duke përfshirë në analizën financiare të rishikuar shumën 5.000 euro, si pagesë e kryer nga personi tjetër i lidhur, ***. ***, për blerjen e apartamentit në Tiranë¹⁷ [...].*

12.9 Komisioni, për pasuritë “Apartament banimi me sipërfaqe 84,54 m²” dhe “Garazh me sipërfaqe 14 m²”, ndodhur në ***, Tiranë, arrin në përfundimin se: [...] *duke pasur parasysh*

¹³ Referohuni arsytimit të Komisionit, në prg. 30 të vendimit

¹⁴ Referohuni arsytimit të Komisionit, në f. 19-20 të vendimit.

¹⁵ Referohuni arsytimit të Komisionit, në prg. 33.5 të vendimit.

¹⁶ Referohuni arsytimit të Komisionit, në prg. 34.2 të vendimit.

¹⁷ Referohuni arsytimit të Komisionit, në prg. 36.2 të vendimit.

deklarimet e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën Vetting, raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike vjetore, provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe provat shkresore të administruara sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, vlerësoi se burimet e përdorura për financimin e pasurisë janë në harmoni me deklaratimet e subjektit në Deklaratën e pasurisë Vetting dhe me deklaratimet dhe logjikën e përdorur gjatë procesit të rivlerësimit dhe se, referuar analizës financiare të rishikuar, subjekti ka justifikuar blerjen e pasurisë me të ardhura të ligjshme¹⁸[...].

12.10 Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosje të Komisionit, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së të datës 23.4.2024, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni lidhur me vlerësimin e burimeve të ligjshme të krijimit për pasuritë “Apartament banimi me sipërfaqe 84,54 m²” dhe “Garazh me sipërfaqe 14 m²”, ndodhur në ***, Tiranë, për sa vijon:

12.10.1 Në lidhje me të ardhurat “nga punësimi i bashkëshortes në shoqërinë “*** **”, në vlerat 420.000 lekë, në vitin 2008, dhe 300.000 lekë, në vitin 2009, vlerësohet se ligjshmëria e këtyre të ardhurave, mbeti e paprovuar edhe pas prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, pasi nga aktet e administruara në dosje rezulton se:

- Nuk provohet që marrëdhënia e punësimit ndërmjet personit të lidhur, znj. ***, me shoqërinë “*** **” të jetë e rregulluar me një kontratë apo formë tjetër të njohur nga ligji;
- Mbeti në nivel deklarativ vlera e pretenduar e të ardhurave nga shoqëria “*** **”, pasi shuma e pretenduar nuk rezulton të ketë kaluar nëpërmjet sistemit bankar apo në ndonjë formë tjetër të përcaktuar në legjislacionin në fuqi;
- Instituti i Sigurimeve Shoqërore¹⁹ i ka konfirmuar znj. *** ** se: [...] për subjektin fizik “*** **, *** **” për periudhën janar 2007 - dhjetor 2009, nuk ju figuron emri në listëpagesa [...];
- Edhe për sa i përket pretendimit të subjektit mbi mosdijeninë lidhur me pagesën e këtyre detyrimeve nga punëdhënësi, vlerësohet si i paprovuar, pasi sikundër ka rezultuar nga hetimi administrativ, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk rezulton të ketë përfituar të ardhura për periudhën e lindjes në vitet 2009 e në vijim, çka bazuar në legjislacionin në fuqi, përfitohet vetëm në rast periudhë sigurimi prej 12 muaj përpara lindjes²⁰.

12.10.1.1 Për sa më sipër, **Komisioneri Publik**, duke sjellë në vëmendje se si të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, konsiderohen vetëm të ardhurat për të cilat nga institucionet përgjegjëse konfirmohet dhe pagimi i detyrimeve tatimore, vlerëson të pabazuar përfundimin e Komisionit mbi përfshirjen e këtyre të ardhurave

¹⁸ Referohuni arsyetimit të Komisionit, në prg. 39 të vendimit.

¹⁹ Referohuni në shkresën nr.*** prot., datë **.11.2022, Drejtoria e Arkivit Qendror, administruar në dosje të Komisionit.

²⁰ Personi i lidhur ka lindur fëmijën e parë në datën **.9.2009, ndërkohë që në legjislacionin në fuqi, ligji nr.7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Rregullore nr. 37, e ISSH-së, datë 23.12.2004, “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e përfitimeve afatshkurtra”; Rregullore nr. 494, e ISSH-së, datë 5.10.1993, “Për lëshimin e raporteve për paaftësi të përkohshme në punë”, neni 27 parashikon se: [...] E ardhura për barrëlindje: 1. E ardhura për barrëlindje i paguhet gruas së siguruar për barrën dhe lindjen e fëmijës, kur ajo ka 12 muaj periudhë sigurimi, për çdo rast përfitimi. Përfshihet nga rregulli për periudhën e sigurimit rasti kur e drejta e pagesës për barrëlindjen e radhës ndodh brenda 24 muajve nga data e lindjes së fëmijës së mëparshëm [...].

në mesin e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për periudhat respektive.

12.10.2 Në lidhje me “mbulimin/financimin e shpenzimeve të kredisë nga vjehri *** **”, sipas deklaramit në pyetësorin standard, **Komisioneri Publik** konstaton se vlerësimi i Komisionit nuk mbështetet në aktet në dosje dhe ligjin e zbatueshëm. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: [...] *Në vitin 2008, vjehri im, z. *** ***, ka financuar pagesën e kësteve të kredisë të paguara gjatë vitit 2008, në shumën rreth 2800 euro, si dhe gjithë shpenzimet e udhëtimit tim dhe bashkëshortes në SHBA, në korrik të vitit 2008. Nga janari i vitit 2009 deri në shtator të vitit 2009, janë financuar nga vjehri im, *** **, nga kursimet e familjes së tij shuma prej rreth 3200 (tre mijë e dyqind) euro, për të paguar këstet e kredisë së marrë pranë ish-*** bank, sot *** Bank (kontribut për t’i ardhur në ndihmë vajzës së tij). Nga janari i vitit 2010 deri në shtator të vitit 2010, janë financuar nga vjehri im, *** **, nga kursimet e familjes së tij, shuma prej rreth 2750 (dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro, për të paguar këstet e kredisë së marrë pranë ish-*** bank (kontribut për t’i ardhur në ndihmë vajzës së tij). Burimi i shumave të financuara nga vjehri im, z. *** **, janë kursimet e realizuara nga të ardhurat e pagave të tij, bashkëshortes ***. ***. dhe djalit ***. ***. [...].*

12.10.2.1 Nga verifikimi i akteve të depozituara pranë ILDKPKI-së, në Deklaratën “Vetting” dhe deklaratave periodike vjetore, të cilat, për këtë proces, bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, kanë vlerën e provës, nuk rezulton që subjekti apo personi i lidhur me të, të kenë deklaruar këtë financim, qoftë si një nga burimet e të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e kësteve të kredisë, apo në seksionin ku kërkohet të deklarohen dhurata/trajtime preferenciale, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, sipas të cilit kërkohet të deklarohej në deklaratat periodike vjetore çdo dhurim mbi vlerën 10.000 lekë²¹.

12.10.2.2 Shumat e pretenduara të financuara, nuk rezultojnë të jenë deklaruar as në D-“Vetting”, dokument i cili është hartuar nga ligjvënësi, me qëllim plotësimin nga ana e subjekteve të rivlerësimit dhe korigjimin e pasaktësive në mënyrën e deklaramit ndër vite, përmes së cilës asetet dhe burimet e krijimit të tyre duhen të deklarohen plotësisht dhe të justifikohen ligjërisht. Ky detyrim i subjekteve buron nga dispozitat kushtetuese të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe parashikimet e ligjit nr. 84/2016, që përcaktojnë në mënyrë të qartë detyrimin e subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur/të tjerë të lidhur me të, për të deklaruar me saktësi në Deklaratën “Vetting” dhe për të justifikuar vërtetësinë e deklaramive për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

12.10.2.3 Arsyetimi dhe vlerësimi i Komisionit se deklaramet e subjektit në përgjigjet e pyetësorit standard, lidhur me shumat e financuara nga ana e vjehrrit, të dhëna për mbulimin e kësteve të kredisë, duhet të konsiderohen të besueshme, në analogji me qëndrimin e Kolegjit

²¹ Neni 4, pika 1, germa F e ligjit nr. 9049/2003, përcakton se: [...] *subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklaramit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjenden deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: f) dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhurata trajtimet preferenciale. Nuk deklarohen dhurata ose trajtim preferencial kur vlera e tyre është më e vogël se 10 000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe kur dy e më shumë dhurata ose trajtime preferenciale, të dhëna nga i njëjti person, së bashku, nuk e kalojnë këtë vlerë, gjatë së njëjtës periudhë deklarimi [...].*

në jurisprudencën e tij (vendimin (JR) nr. 2, datë 2.2.2023), nuk vlerësohet i drejtë dhe nuk bazohet me situatat faktike dhe ligjore.

12.10.2.4 Nga ana tjetër, neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se, në momentin e krijimit të një marrëdhënie huaje/dhurimi, huadhënësi/dhuruesi klasifikohet si “një person tjetër i lidhur” dhe duhet të justifikojë ligjshmërinë e burimeve të përdorura për krijimin e pasurisë. Edhe pse në këtë rast nuk ka prova që të konfirmojnë ekzistencën e një marrëdhënie të tillë, nuk rezulton të jetë kryer nga Komisioni ndonjë analizë financiare në lidhje me mundësinë financiare të huadhënësit/dhuruesit, për të justifikuar pagesat.

12.10.2.5 Si rrjedhojë, për shkak të mungesës së dokumentacionit në lidhje me këtë financim dhe në konsideratë të jurisprudencës së Kolegjit²², të ardhurat e deklaruara si financim/mbulim nga i vjehri, z. ***. ***, vetëm gjatë hetimit administrativ në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit, vlerësohet se nuk duhet të konsiderohen si të ardhura me burime të ligjshme në analizën financiare të subjektit dhe personit të lidhur me të, për vitet respektive.

12.10.3 Në lidhje me *rishikimin e shpenzimeve të udhëtimit (transporti dhe qëndrimi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës)*, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit standard, ka deklaruar se: “[...] Për periudhën 15/07/2009-16.08.2009, udhëtimi në SHBA me bashkëshorten. Kemi qëndruar në banesën e shoqes së bashkëshortes, ***. ***, me adresë *** ***, ***, ** ***. Unë kam ndenjur deri në datën **.08.2009 (kam mbërritur në Shqipëri më datë **.08.2009), ndërsa bashkëshortja ka qëndruar atje deri në datë **/11/2009. Kemi ndenjur në banesën e saj me strehim dhe ushqim, pa pagesë. Qëllimi ishte lindja e fëmijës, pasi bashkëshortja ishte shtatzënë”. Komisioni, pas vlerësimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në funksion të barrës së provës, ka rishikuar analizën financiare dhe ka llogaritur shpenzimet për këtë periudhë në masën 5 USD në ditë, duke ulur ndjeshëm shpenzimet për vitin 2009 [...].

12.10.3.1 **Komisioneri Publik** ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni mbi përlllogaritjen e kostos ditore në shumën 5 USD, jo vetëm nisur nga kohëzgjatja e periudhës së qëndrimit, por kryesisht bazuar dhe në deklarinimin bërë nga subjekti i vlerësimit në procesverbalin e ILDKPKI-së së datës ** mars 2016, ku në përgjigje të pyetjes: “Sa shpesh keni dalë jashtë shtetit? Sa herë ka qenë për punë dhe sa herë për dalje private? Sa kanë qenë shpenzimet tuaja në udhëtimet private?”, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: “[...] për qëllime private, me sa mbaj mend, kam qenë një herë në Itali me bashkëshorten, kam qenë në SHBA rreth 10-11 herë dhe, meqë bashkëshortja ka jetuar në SHBA, shpenzimet janë mbuluar nga të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes [...]”. Në këtë deklarinim, duket se subjekti i rivlerësimit përpara Inspektorit të ILDKPKI-së specifikisht ka deklaruar burimin e financimit për udhëtimet private jashtë shtetit, duke përfshirë jo vetëm shpenzimet e transportit, por të gjitha shpenzimet e udhëtimit (transport dhe qëndrimi).

12.10.3.2 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit gjatë hetimit administrativ, ka ndryshuar deklarinimin e tij lidhur me burimin e të ardhurave me të cilat ka mbuluar shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit, duke pretenduar: “[...] se në procesverbalin e

²² Referohuni vendimit të Kolegjit (JR) nr. 7/2023, prg. 14.6.

ILDKPKI-së ka deklaruar përballimin e shpenzimeve të udhëtimit/daljeve dhe jo shpenzimet e qëndrimit [...], në funksion të uljes të kostove, për efekt përlllogaritje për procesin e rivlerësimit.

12.10.3.3 Përveç sa më sipër, lidhur me këto shpenzime, konstatohet se nga aktet në dosje, nuk rezulton që të jetë bërë ndonjë deklarim nga subjekti, lidhur me shpenzimet mjekësore gjatë shtatzënive dhe lindjes së fëmijëve në SHBA, shpenzime të cilat, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së²³, duket se janë të konsiderueshme²⁴.

12.10.3.4 Gjithashtu, në të njëjtin arsyetim, **Komisioneri Publik** vlerëson të pambështetur dhe vlerësimin e Komisionit mbi rishikimin e mbulimit të një pjese të shpenzimeve të udhëtimit nga babai i bashkëshortes, sipas deklarimeve të subjektit në pyetësorin standard, për sa kohë që ky pretendim i subjektit bie në kundërshtim me deklaratimet e tij në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën **.3.2016, trajtuar më sipër. Mbulimi/financimi i kostove nuk rezulton i deklaruar në deklaratat periodike vjetore të kohës referuar kërkesave dhe parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar.

12.10.4 Në lidhje me “*rishikimin e të ardhurave të përfituara nga bashkëshortja në SHBA*”, nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosje të Komisionit, si dhe në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së, të datës 23.4.2024, Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, për sa vijon:

12.10.4.1 Subjekti i rivlerësimit, në Deklaratën “Vetting” dhe deklaratat periodike vjetore, si dhe në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, ka deklaruar vlera të ndryshme të përfituara nga bashkëshortja e tij në SHBA, si në formën e ndihmës/asistencës sociale, ashtu dhe në formën e rimbursimit të taksave. Aktet e depozituara gjatë hetimit administrativ nuk provojnë përfitimin e vlerave të deklaruara dhe pretenduara nga subjekti, vlera të cilat duket se janë marrë në konsideratë nga Komisioni në analizën financiare të rishikuar.

12.10.4.2 Subjekti i vlerësimit nuk rezulton të ketë paraqitur prova/akte në mbështetje të pretendimeve të tij gjatë hetimit administrativ, lidhur me shumat e pretenduara si të përfituara nga bashkëshortja në formën e ndihmës sociale, si dokumente zyrtare, lëvizje të llogarive bankare, cek bankar, apo ndonjë të dhënë për të mbështetur dhe provuar shumat e pretenduara dhe kohën e tërheqjes së tyre, nisur kjo dhe nga fakti se, konkretisht, shuma totale e pretenduar nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit, e ardhur në formën e ndihmës ekonomike/asistencës sociale nga shteti, rreth 21.211 USD, e tejkalon ndjeshëm shumën e deklaruar nga subjekti, në deklaratat periodike vjetore (DV), rreth 14.842 USD dhe në Deklaratën “Vetting”, 18.691 USD, mospërputhje, të cilat ngrenë dyshime mbi saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve financiare të subjektit dhe personit të lidhur me të.

12.10.4.3 I pabazuar vlerësohet rishikimi i shpenzimeve të llogaritura nga Komisioni për sa i përket zërit “*Shpenzime qiraje*”, si pjesë përbërëse e zërave mbi të cilat janë llogaritur kostot e jetesës së familjarëve në SHBA, për sa kohë që dhe vetë shpenzimet e qirasë nga ana e Komisionit janë llogaritur aq sa ka pretenduar subjekti, pa u mbështetur në dokumentacion²⁵.

12.11 Në përfundim, për pasuritë “*Apartament banimi me sipërfaqe 84,54 m²*” dhe “*Garazh me sipërfaqe 14 m²*”, ndodhur në ***, Tiranë, **Komisioneri Publik**, në analizë të

²³ <https://policyscout.com/health-insurance/learn/costs-childbirth-by-state>

²⁴ Mesatarisht rreth 10.000 USD, në varësi nëse është një lindje normale apo një lindje me operacion cezarian.

²⁵ Referohuni vendimit nr. 8/2023 (JR), datë 2.3.2023, prg. 20.10.

gjithë sa trajtuar më sipër mbi burimet e ligjshme të pasurisë në fjalë, vlerëson se përfundimi i arritur nga Komisioni për këtë pasuri nuk mbështetet në aktet në dosje dhe subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, i lidhur me nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

13. Mbi mungesën e burimeve të ligjshme dhe analizën financiare të shpenzimeve dhe kursimeve në cash ndër vite. Përveç sa më sipër trajtuar për pasuritë: “*Apartament banimi me sipërfaqe 84,54 m²*” dhe “*Garazh me sipërfaqe 14 m²*”, ndodhur në ***, Tiranë, Komisioneri Publik, nga vlerësimi i akteve në dosje, bazuar në Rekomandimin e ONM-së, datë 23.4.2024, sjell në vëmendje dhe çështjet si më poshtë, për të cilat ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni:

13.1 Të ardhurat e deklaruara të përfituara nga lotot sportive

13.1.1 Në D-Vetting dhe DV-2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka përfituar nga lotot sportive shumën prej 7.451 euro, në vitin 2010. Komisioni, duke i vlerësuar bindëse provat dhe shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit, në analizën financiare të rishikuar, ka përfshirë shumën 4.000 euro si të ardhur të ligjshme për vitin 2010, sipas pretendimit të subjektit mbi ndarjen e një pjese të të ardhurave me të vëllain²⁶.

13.1.2 Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosje të Komisionit, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi konkluzioni si më sipër bie ndesh me jurisprudencën e Kolegjit.

13.1.3 Nga aktet e administruara në dosje rezulton se, akti i vetëm i konsideruar si provë lidhur me këto të ardhura, është një shkresë nga kompania e bastit “**** **”²⁷, që konfirmon se disa bileta (*listuar vetëm katër bileta përkundrejt pretendimit të subjektit se biletat fituese kanë qenë gjithsej pesë*) me numra seriale të ndryshëm, rezultuan fituese për shumën e deklaruar. Nga sa më sipër, nuk rezulton që në dosje të Komisionit të jetë administruar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar krijimin e të ardhurave nga loto sporti, të cilat të provojnë se kjo shumë është përfituar nga subjekti i rivlerësimit.

13.1.4 Komisioneri Publik vlerëson se qëndrimi i Komisionit mbi konsiderimin e shumës 4.000 euro, në vitin 2010, në mesin e burimeve të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve dhe kursimeve, bie ndesh me jurisprudencën e Kolegjit²⁸, sipas së cilës, trupi gjykues ka arritur në përfundimin se: [...] *duke qenë se biletat e lotarive sportive nuk kanë gjeneralitete, nga të cilat të mund të identifikohet fituesi, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë përkatësinë dhe ligjshmërinë e këtyre të ardhurave* [...].

13.2 Mbi kursimet e deklaruara në cash nga ana e subjektit të rivlerësimit

13.2.1 Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar posedimin e kursimeve *cash* në shumat 10.200 USD dhe 70.000 lekë.

²⁶ Referohuni deklarimeve të subjektit në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit.

²⁷ Për më tepër që nga aktet në dosje ka rezultuar se vërtetimi i lëshuar nga shoqëria “**** **” është firmosur nga administratori i saj, *** **, i cili, referuar përgjigjeve të subjektit në Pyetësorin nr. 2 të Komisionit, është kushëriri i bashkëshortes, nga i cili, në vitin 2016, subjekti ka blerë një automjet, sipas kontratës së datës **.10.2016.

²⁸ Referohuni vendimit (JR) nr. 8/2018.

13.2.2 Në deklaratat periodike vjetore, duke filluar nga viti 2005 e në vijim, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar kursime në *cash* dhe ndryshime (shitesa/pakësime) për to.

13.2.3 Komisioni, bazuar në analizën financiare të kryer dhe pamjaftueshmërisë së konstatuar në mbulimin me burime të ligjshme të shpenzimeve dhe kursimeve ndër vite²⁹, ka vlerësuar se do të konsiderohet përdorimi i kursimeve në *cash* nga ana e subjektit të rivlerësimit sipas deklarimeve të tij në deklaratat periodike vjetore, vetëm për ato vite për të cilat është provuar se kursimi në *cash* i deklaruar në vitet e mëparshme mbulohet me burime të ligjshme. Bazuar në këtë arsyetim, Komisioni ka kryer analizën financiare të subjektit dhe personave të lidhur me të, vetëm për periudhën 1.1.2016 - 31.12.2016, analizë nga e cila ka rezultuar se subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme kursimet e deklaruara dhe shpenzimet për një diferencë negative prej – 1.812.203 lekë³⁰.

13.2.4 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për të paraqitur shpjegime/prova, për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

13.2.5 Subjekti i rivlerësimit, në prapësime të rezultateve të hetimit administrativ, ka kundërshtuar argumentet e Komisionit mbi mospërfshirjen e kursimeve të deklaruara në *cash* për vitet kur është evidentuar mungesa e burimeve të ligjshme në mbulimin e tyre, si dhe trajtimin e kursimeve në *cash* të vitit 2012³¹.

13.2.6 Komisioni, për sa më sipër, ka vlerësuar të drejtë pretendimet e subjektit, në përfundim, duke arsyetuar se: [...] *Në këtë mënyrë, sikurse me të drejtë subjekti pretendon, deklarimi i gjendjes cash në Deklaratën Vetting përputhet me deklarimin e gjendjes cash, deklaruar në DPV-në e vitit 2016. Më tej, gjatë vitit 2016, subjekti ka pasur pakësim të gjendjes cash në shumën 12.500 USD dhe 130.000 lekë [...]*³².

13.2.7 Komisioneri Publik, për sa më sipër, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit,³³ ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni. Për sa argumentuar dhe më sipër, në trajtimin e zërave të pasurisë: “*Apartament banimi me sipërfaqe 84,54 m²*” dhe “*Garazh me sipërfaqe 14 m²*”, për aq kohë sa nga analiza financiare rezulton se kursimet e deklaruara në *cash* nuk mbulohen nga burime të ligjshme, në përputhje me kërkesat e nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, këto kursime të deklaruara nuk mund të shërbejnë si burim krijimi për mbulimin e shpenzimeve apo krijimin e pasurive, të luajtshme apo të paluajtshme, në vitet e mëpasshme³⁴.

²⁹ Referohuni analizës financiare të kryer nga Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ.

³⁰ Komisioni, në analizë të mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, për krijimin e likuiditeteve *cash* të deklaruara ndër vite, për periudhën 2003-2008, në përfundim të hetimit administrativ, për vitin 2008, i ka rezultuar pamjaftueshmëri financiare në shumën -1.334.380 lekë, nga ku duket se nuk kanë pasur mundësi financiare nga burime të ligjshme të ardhurash për pagesën e këstit të blerjes së apartamentit dhe garazhit, kursimin e deklaruar në *cash* (400.000 lekë), si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe evidentuara për vitin 2008, duke i kaluar subjektit barrën e provës; (ii) Në vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2013, në të cilat subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitesa në kursime *cash* në vlerë totale 500.000 lekë dhe 17.000 euro³⁰, referuar analizës paraprake të Komisionit rezulton në dukje me balanca negative, përkatësisht në vlerat -427.492 lekë; -1.384.680 lekë; -374.109 lekë dhe -719.299 lekë.

³¹ Referohuni prapësimeve të subjektit të rivlerësimit.

³² Prg. 46.I i vendimit të arsyetuar.

³³ Referohuni arsyetimit mbi kursimet *cash* në vendimin (JR) nr.18/2022, prg. 31 e në vijim; vendimit (JR) nr. 26/2022.

³⁴ Nga analiza financiare, bazuar dhe në trajtimin e zërave të analizuar përgjatë ankimit, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon tërësisht shpenzimet dhe kursimet në *cash* të deklaruara për vitet 2007 (rishikuar shpenzimet e jetesës sipas INSTAT) deri në vitin 2013 dhe për vitet 2015-2016.

14. Në përfundim, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, **Komisioneri Publik**, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, bazuar në aktet e administruara në dosje të Komisionit, si dhe bazuar në legjislacionin e zbatueshëm dhe jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; dhe (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe kryerjen e shpenzimeve ndër vite, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 3, i lidhur me nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

IV.B. Lidhur me kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale

IV. B-1. Kontrolli i figurës

15. Komisioni, lidhur me kontrollin e kriterit të figurës, ka arritur në përfundimin se: [...] *pas hetimit të kryer në lidhje me këtë kriter, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, Valentin Preçi, ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës³⁵[...].*

16. Nga aktet e administruara në dosje të Komisionit, rezulton se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.6.2020³⁶, protokolluar në Komision me nr. ***/*, datë **.7.2020, ka dërguar informacion lidhur me të dhënat në TIMS, përfshirë automjetet/targat me të cilat ka udhëtuar subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, si dhe personat e tjerë që kanë lëvizur me këto automjete. Dy episode, ndër udhëtimet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, janë konkretisht: (1) më datë **.6.2012, ora 00:46, është regjistruar dalje me mjetin me targa *** ***, ku në kolonën shofer është regjistruar shtetasi *** *** dhe si pasagjer *subjekti i rivlerësimit*, së bashku me dy persona shoqërues, me vend kalim kufitar “Pika Kufitare Murriqan” dhe hyrje në territorin shqiptar të *subjektit të rivlerësimit*, në të njëjtën datë, në orën 03:59, me të njëjtin automjet, të njëjtin shtetas si shofer dhe të njëjtët persona shoqërues; (2) Më datë **.7.2012, ora 20:38, është regjistruar dalje me mjetin me targa *** ***, me dy persona, ku në kolonën shofer është regjistruar shtetasi *** *** dhe si pasagjer *subjekti i rivlerësimit*, me vend kalim kufitar “Pika Kufitare Morinë”.

17. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datës 10.7.2020, pas dërgimit të pyetësorit standard nga Komisioni³⁷, për udhëtimin e datës **.6.2012, ka deklaruar se: [...] *kam udhëtuar me z. *** ***, i cili po shkonte për arsyet e tij në Mal të Zi. Rastësisht kam mësuar se kishte për të shkuar në Mal të Zi dhe i kam kërkuar të udhëtoj me të, me qëllim për t'i dërguar një pako me medikamente mikut tim *** *** [...]. Për udhëtimin e datës **.7.2012 ka deklaruar se: [...] udhëtim në Prizren me shtetasin *** ***. Takimi ishte i rastësishëm dhe, meqenëse erdha në dijeni të udhëtimin të tij, mendova të shkoja, me qëllim të shihja qytetin e Prizrenit [...].*

³⁵ Referohuni prg. 58.4, faqe 55 e vendimit.

³⁶ Shkresa nr. ***/* prot., datë **.1.2023, e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit jep informacion, si për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur, duke shtuar edhe persona të tjerë në rrethin e familjarëve të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij.

³⁷ Referohuni pyetjes 12 të Komisionit dhe përgjigjes së subjektit të rivlerësimit.

18. Komisioni në aktin: ³⁸“Rezultatet e hetimit administrativ ...”³⁹, ka kërkuar shpjegime nga subjekti i rivlerësimit, pasi: [...] *duket se udhëtimet me persona të ekspozuar politikisht dhe të proceduar penalisht cenojnë etikën e magjistratit... jepni shpjegimet tuaja lidhur me këto konstatime [...].* Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, në aktin:⁴⁰ “Shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ...”, pikat 252-261, ka dhënë detaje të këtyre udhëtimeve.

19. Komisioni ka arritur në përfundimin⁴¹ se: [...] *subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime që cenojnë figurën, etikën dhe integritetin e tij si magjistrat [...], dhe rendit⁴² ato rrethana që e kanë bindur Komisionin, të cilat mund të grupohen se: [...] takimi ka qenë rastësor dhe se të dhënat e organeve ligjzbatuese [...] nuk kanë provuar kontakte apo komunikime elektronike/telefonike, udhëtime të tjera të subjektit me këta shtetas.*

20. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosje të Komisionit, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, të datës 23.4.2024, ndan qëndrim të ndryshëm me përfundimin e arritur nga Komisioni lidhur me kontrollin e figurës.

20.1 Në aktin Rekomandim të ONM-së, datë 23.4.2024, ndër të tjera, parashtrohet sa në vijim: [...] *Për sa i përket këtyre takimeve të rastësishme, është me rëndësi të theksohet se nuk ka pasur një analizë të kontakteve dhe historisë së tyre; Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit nëse ai duhej apo nuk duhej të deklaronte kontaktet në deklaratën e kontrollit të figurës dhe në mungesë të një analize kritike me lehtësi arriti në përfundimin e mungesës së problematikave. Është kërkesë ligjore që subjekti i rivlerësimit duhet të tregojë për kontaktet e mundshme të papërshtatshme, veçanërisht përderisa një nga vëllezërit sipas informacioneve publike nga burime të faqeve digjitale të lajmeve, ishte i akuzuar më parë për shfrytëzim të prostitucionit dhe pastrim të parave. Në këndvështrimin tonë, subjekti i rivlerësimit dështoi të përmbushte këtë detyrim; Mungon gjithashtu analiza, nëse formalisht ai [subjekti i rivlerësimit] - shënim i ynë - ka dështuar të deklarojë kontaktet dhe a mund të kualifikohet kjo sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr.84/2016; Gjithashtu mungon një vlerësim i kujdesshëm i natyrës reale të këtyre kontakteve. Komisioni, bazuar vetëm në shpjegimet e subjektit, në mënyrë të parakohshme, ka arritur në përfundimin se këto ish-in kontakte të rastësishme, pa kryer një vlerësim të hollësishëm; Komisioni duhet të ndiqte një qasje më tepër kritike dhe të vlerësonte nëse këta individë ish-in akuzuar si persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe si dhe apo plotësisht kjo do të afektonte pozitën e subjektit të rivlerësimit si magjistrat; Duke pasur parasysh famën e familjes ***, një vëzhgues i zakonshëm ka të ngjarë të mos jetë dakord që një magjistrat të udhëtojë me individë të tillë [...].*

20.2 Bazuar në rregullimet ligjore të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës, nenet 34, 35 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016, në pajtueshmëri me çështjet ligjore⁴³ të ngritura në Rekomandimin e ONM-së, të datës 23.4.2024, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, në zbatim të dispozitës kushtetuese, nenit DH, “Kontrolli i figurës”, pika 2, duhet të plotësonte dhe dorëzonte një deklaratë të detajuar për kontrollin e figurës, që mbulon periudhën nga data 1

³⁸ Rezultatet e hetimit i janë dërguar subjektit në datën 21.11.2023, referohuni pikës 6 të vendimit.

³⁹ Referohuni në faqen 42 të tyre.

⁴⁰ Akti ka të shënuar datën ** dhjetor 2023.

⁴¹ Referohuni faqes 75 të vendimit.

⁴² Referohuni faqes 74 të vendimit.

⁴³ Referohuni Rekomandimit, pika 2. “Vlerësimi i figurës”, faqe 6 dhe 7.

janar 2012 deri në ditën e deklarimit sipas ligjit⁴⁴. Në *Deklaratën e kontrollit të figurës*, pjesa 5, “*Të dhëna për sigurinë*”, pyetja në germën “c”, kërkon nga subjekti i rivlerësimit që të deklaronte nëse ka pasur kontakt të papërshtatshëm me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës, duke plotësuar me përgjigjen *po* ose *jo*, nëse *po* duhet të jepen të dhënat e identitetit të personit, lidhjen me të dhe të dhënat për veprat penale për të cilat është hetuar ose/dhe akuzuar.

20.3 Për sa më sipër, çmohet se rrethanat e dala nga të dhënat e sistemit TIMS për episodet e udhëtimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të tilla si personat me të cilët ka udhëtuar, ora e udhëtimit (*ora e daljes nga territori shqiptar dhe ajo e hyrjes*), si dhe personat e tjerë shoqëruar në udhëtim, nuk mbështesin pretendimin e subjektit të rivlerësimit se këto takime ishin takime të rastësishme, me njerëz krejtësisht të panjohur.

20.4 Referuar të dhënave publike⁴⁵, lidhur si me hetime penale apo vendime gjyqësore penale, pasqyruar gjerësisht publikisht dhe shpeshherë pas vitit 2013, të dy shtetasit, ***, ***, dhe ***, ***, kanë qenë subjekte të hetimeve penale dhe dënimeve në zbatim të vendimeve gjyqësore për kryerjen e veprave penale me rrezikshmëri të lartë⁴⁶, rrethana këto që duhet të ndërjegjësonin subjektin e rivlerësimit, aq më tepër në funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, në juridiksionin tokësor të së cilës kanë ndodhur ngjarjet/veprat penale, të deklaronte në deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, faktin e udhëtimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në periudhën qershor - korrik 2012, në dy episode të ndara me këta shtetas. Deklarimi nga subjekti i rivlerësimit do t’iu mundësonte autoriteteve verifikuese, fillimisht, kryerjen e hetimeve përkatëse dhe arritjen në përfundimin përkatës, në harmoni me rrethanat e faktit, nëse ekzistonte apo jo kontakti i papërshtatshëm.

20.5 Në përfundim të sa më sipër, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, **Komisioneri Publik**, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së, konstaton se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm edhe për kriterin e kontrollit të figurës, parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka plotësuar saktë “*Deklaratën për kontrollin e figurës*”, sipas Shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kontaktet me shtetasin ***, ***, i cili rezultoi si person i përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016.

20.6 Gjithashtu, në Rekomandimin e ONM-së, të datës 23.4.2024, parashtrohet se kjo e dhënë e administruar gjatë hetimit dhe kontrollit të figurës, justifikon rishikimin nga Kolegji edhe në drejtim të treguesit të “*Etikës*”, për këto arsye: [...] *Në vijim të arsytimit të përshkruar në pikën 2 më sipër, nëse këto kontakte nuk do të konsideroheshin si të papërshtatshëm sipas kriterit të kontrollit të figurës, atëherë duhet të ishte kryer një analizë e veçantë për qëllime etike në kriterin e vlerësimit të profesionalizmit dhe vlerësimin e përgjithshëm të çështjes. Për sa i përket etikës dhe përkushtimit ndaj vlerave profesionale, nuk jemi dakord me pohimin se*

⁴⁴Deklarata për kontrollin e figurës plotësohet sipas Shtojcës 3, bashkëngjitur ligjit nr. 84/2016, me afat të dorëzimit dhe dërgimit pranë Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e ligjit, sipas përlllogaritjes me datë fundore të periudhës, datën 31 janar 2017.

⁴⁵ <https://gjykata.gov.al/>

⁴⁶ Shtetasi ***, ***, i hetuar dhe dënuar për krimin e vrasjes. Shtetasi ***, ***, i hetuar, akuzuar dhe dënuar për krimet e parashikuara nga nenet 287/2/b/3, 257/a/2, dhe 199/a/3 të Kodit Penal, referuar vendimit penal të Gjykatës e Rrethit Gjyqësor, Tiranë nr.***, datë **/4.2017, dhe vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. **/***.***, datë **/12.2017.

udhëtimi me vëllezërit *** ishte i rastësishëm. Koincidenat e përmendura në përgjigjet e subjektit të rivlerësimit janë të shumta dhe jo bindëse. Fillimisht takohet rastësisht me *** *** dhe udhëton për në Mal të Zi, më pas, disa javë më vonë, me *** *** në Kosovë. Për më tepër, *** *** ishte pronar në kompaninë e basteve, nga e cila vlerësuesi kishte marrë një vërtetim konfirmimi, ku thuhet se kishte marrë 7,451 euro në vitin 2010. Këto rrethana paraqesin shumë pikëtakime për t'u hedhur poshtë dhe nuk e mbështesin pretendimin e subjektit të rivlerësimit se këto takime ishin takime të rastësishme me njerëz krejtësisht të panjohur. Prandaj, duhet të ishte bërë një analizë e plotë për të vlerësuar implikimin etik të këtyre ndërveprimeve nën kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale [...].

20.7 Nga aktet e administruara në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit, në *D-Vetting*, në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, pyetja nr.10, si dhe procesverbalin e datës *.3.2016, mbajtur në ILDKPKI, ka paraqitur aktin e emërtuar “Vërtetim” me datë *.11.2010, sipas të cilit nga kompania “*** **”, subjekti, në datën *.11.2010, ka fituar neto 7.451 euro. Referuar të dhënave publike, aksionar në këtë shoqëri rezulton edhe shtetasi *** **, një e dhënë tjetër kjo, e cila duhej të ishte objekt i analizës nga Komisioni në kontekstin e historikut të marrëdhënieve, duke hedhur dyshime mbi vërtetësinë e rastësisë së kontakteve të evidentuara midis subjektit të rivlerësimit dhe shtetasin *** **.

21. Komisioneri Publik vlerëson se edhe kjo gjetje duhet çmuar si rrethanë që lidhet me etikën e magjistratit, në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kritereve, sipas parashikimit në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

IV. B-2. Konflikti i interesit

22. Në *D-Vetting*, rubrika “Të dhënave konfidenciale”, ndër të tjera, subjekti deklaroi: “Donacion në *** Bank për djalin e sëmurë shuma e derdhur nga *** *** **, në llogari në vlerën 30.000 lekë. Lidhja me subjektin shoqërore”.

22.1 Në DPV-në e vitit 2016, subjekti bën të njëjtin deklaram.

22.2 Komisioni ka kërkuar informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë lidhur me çështje penale të hetuara nga subjekti me shtetasin ***. **, si shtetas apo në cilësinë e ortakut/administratorit të shoqërisë “*** **” sh.p.k., për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe nga përgjigjet⁴⁷ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka hetuar procedimin penal nr. **, viti 2015, me shoqërinë “*** **” sh.p.k. (në cilësinë e palës së dëmtuar) për veprën penale “Vjedhje”, hetim i pezulluar nga subjekti më datë *.10.2015.

22.3 Komisioni, me aktin “Rezultate të hetimit administrativ ...”, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka konstatuar se: [...] (i) subjekti ka hetuar një procedim penal me palë të dëmtuar shoqërinë “*** **” sh.p.k., çështje penale, e cila është ende nën hetim, pasi, sipas informacionit të administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, rezulton e pezulluar; (ii) Në DVP ka konfirmuar marrëdhënien e miqësisë me shtetasin ***. **, në cilësinë e ortakut të vetëm/administratorit të shoqërisë “*** **”; (iii) Ka pranuar donacion/dhuratë në vlerën 30.000 lekë, duket se subjekti i rivlerësimit ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 5, pika 1, shkronjat “c” dhe “dh/v”,

⁴⁷ Shkresë kthim përgjigje nr. ***/* prot., datë *.12.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, drejtuar Komisionit.

të ligjit nr. 9367/2005 dhe në bazë të nenit 17, shkronja “ë” dhe nenit 26/1 të Kodit të Procedurës Penale, ka pasur detyrimin ligjor të heqë dorë nga hetimi i çështjes për të mos vepruar në kushtet e konfliktit të interesit [...]. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet e tij në aktin “Shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ...”⁴⁸.

22.4 Komisioni, në vijim ka arritur në përfundimin⁴⁹ se: [...] Nga verifikimi i veprimeve hetimore të kryera rezultoi se subjekti ka përmbushur plotësisht detyrën e prokurorit, duke urdhëruar sipas ligjit kryerjen e veprimeve hetimore të nevojshme, të cilat janë përpara se shtetasi ***. *** të kryente donacionin për djalin e tij, në vlerën modeste prej 30.000 lekësh, dhe më pas ka vendosur pezullimin për shkak të mosidentifikimit të autorit, pa u ndikuar në vendimmarrje nga asnjë rrethanë e caktuar kohore, që do të përbënte konflikt të mundshëm interesi [...].

22.5 Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosje të Komisionit, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, të datës 23.4.2024, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni dhe vlerëson se kjo çështje duhet mbajtur në konsideratë në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kritereve, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

23. Në aktin Rekomandim të ONM-së, datë 23.4.2024, ndër të tjera, parashtrohet sa në vijim: [...] Situata e konfliktit të interesit ka të bëjë me shtetasin *** ***, të cilin i vlerësuari e ka deklaruar mik dhe që i ka dhuruar 30.000 lekë. Z. *** ishte përfshirë edhe në një procedim penal, ku shoqëria e tij ishte objekt vjedhje, me pasojë vjedhjen e një sasive të konsiderueshme parash... Megjithatë, Komisioni arriti në përfundimin se nuk ka asnjë provë që sugjeron se ata ishin miq në vitin 2015. Për më tepër, nuk ka tregues të qartë të konfliktit të interesit nga ana e subjektit të rivlerësimit, veçanërisht duke marrë parasysh shumën simbolike të dhurimit. Megjithatë, procedimi në lidhje me vjedhjen aktualisht është pezulluar për faktin se autori nuk është identifikuar... Arsyetimi i Komisionit ka mangësi, pasi duket praktikisht e pamundur për prokurorin që trajton një rast, ku një shoqëri tregtare është viktimë e një vjedhje, të mos dijë identitetin e vetëm të aksionarit dhe administratorit të shoqërisë. Në rastet të tilla, veprimi i parë hetimor përfshin identifikimin e administratorit dhe, më pas, mbledhjen e informacionit për stafin, turnet, masat e sigurisë dhe informacione të tjera të domosdoshme... Së dyti, jo vetëm marrëdhëniet konkrete të interesit përbëjnë shkelje etike, por magjistratët duhet të shmangin çdo perceptim të situatës së konfliktit dhe të kujdesen që të shmangin në çdo rast atë, por edhe përzjerjen në të gjitha ato situata, të cilat perceptohen se e përfshijnë apo krijojnë për magjistratët konflikt interesi. Ky perceptim duhet të bazohet në këndvështrimin e një vëzhguesi të arsyeshëm, të drejtë dhe të mirinformuar. Në momentin që ata bëhen të vetëdijshëm për një situatë të tillë, edhe nëse duket të jetë një konflikt i mundshëm i interesit, ata duhet ta njoftojnë për këtë drejtuesin e Prokurorisë. Kjo qasje proaktive është thelbësore për të ruajtur integritetin dhe pavarësinë e procesit ligjor... Së treti, konsiderimi i shumës së dhuruar prej 30,000 lekëve si “simbolike”, nuk është një argument i vlefshëm, pasi çdo kontribut financiar, sado i parëndësishëm financiarisht të jetë, potencialisht mund të ndikojë në paanësinë e magjistratit. Më tej, fakti që procedimi penal është pezulluar para dhurimit, nuk shmang situatën e mundshme të konfliktit të interesit, për sa kohë çështja mbetet e pezulluar... Në opinionin tonë, subjekti i rivlerësimit duhet të kërkonte heqjen dorë sipas nenit

⁴⁸ Referohuni në pikat 147 – 167 të këtij akti.

⁴⁹ Referohuni pika 48. 9 e vendimit.

17 dhe 26, të Kodit të Procedurës Penale, të cilat kornizojnë procedurat për një gjyqtar të heqë dore nga një çështje për shkaqe të lidhura me paanshmërinë. Ky do të ishte një hap i kujdesshëm për të siguruar integritetin e procesit ligjor [...].

23.1 Rrethanat e lidhura me këtë çështje referuar akteve të administruara në dosje, në mënyrë të përmbledhur, rezultojnë si vijon:

23.1.1 Procedimi penal me numër ***, i vitit 2015, regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, “Vjedhja”, me të dëmtuar shoqërinë “**** ***” sh.p.k., me administrator shtetasin *** ***, është ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, z. Preçi. Me vendimin e datës **.10.2015, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka vendosur pezullim të hetimeve. Komisariati i Policisë Vorë, më datë **.3.2020,⁵⁰ ka dërguar disa dosje hetimore për parashkrim të ndjekjes penale, sipas nenit 66 të Kodit Penal, ku në numrin 2 është listuar dosje penale e pezulluar nr.***, datë **.2.2015. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, deri në çastin kur ky procedim penal i ka kaluar një prokurori tjetër, ka qenë prokurori i këtij procedimi penal.

23.1.2 Referuar *DV-2016* dhe *D-Vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi donacion në shumën 30.000 lekë nga shtetasi *** ***, si lidhje shoqërore e tij.

23.2 Në vlerësimin e **Komisionerit Publik**, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, të datës 23.4.2024, rasti konkret përkufizohet si situatë, e cila mund të përbëjë rast për heqjen dorë nga procedimi penal, pasi subjekti i rivlerësimit, deri në momentin kur procedimi penal i kaloi një prokurori tjetër, ishte prokurori i çështjes dhe gjendej në kushtet e ekzistencës së arsyeve të njëanësisë, sipas nenit 26 dhe nenit 17, të Kodit të Procedurës Penale. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar kujdes të veçantë për të siguruar paanësinë e magistratit në lidhje me konfliktin e interesit, sipas indikatorëve të përcaktuar nga pika 4 e nenit 75, të ligjit nr. 96/2016.

IV. B-3. Denoncimet nga publiku

24. Denoncimi i shtetasit * ***)⁵¹**

24.1 Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit e ka mbyllur çështjen pa hetim, pa marrë në pyetje dëshmitar dhe pa kontaktuar aspak me personin e kallëzuar për veprën penale të mashtrimit. Në denoncimin e tij, ky shtetas pretendon për veprime korruptive dhe mungesë profesionalizmi. Komisioni ka administruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Tiranë dosjen e fashikullit që i përket procedimit penal me numër nr. ***/2018.

24.2 Nga shqyrtimi i dosjes, Komisionit i kanë rezultuar, në mënyrë kronologjike, rrethanat e mëposhtme:

24.2.1 Në datën **.5.2016, mbi bazë të kallëzimit të shtetasit *** ***, në ngarkim të shtetasit *** ***, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, është regjistruar kallëzimi penal me numër ***, për veprën penale të “Mashtrimit”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal.

24.2.2 Në përfundim të veprimeve hetimore nga ana e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, është konkluduar se fakti i mësipërm nuk përmban elemente të veprës

⁵⁰ Referohuni shkresës nr. ***/*, datë **.3.2020, të Komisionariatit të Policisë Vorë, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.

⁵¹ Regjistruar në Komision me nr. *** prot., datë **.9.2018.

penale, pasi kjo është një marrëdhënie juridike civile dhe si e tillë duhet të vendoset mosfillimi i procedimit penal nr. ***, të vitit 2016.

24.2.3 Kundër vendimit për mosfillimin e procedimit penal, ka bërë ankim shtetasi ***, ***, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë **.11.2016, ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuarit ***, ***, dhe anulimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal për kallëzimin penal nr. ***/2016, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë për hetime të mëtejshme.

24.2.3.1 Ndër të tjera, kjo Gjykatë ka arsyetuar se: [...] në përfundim të gjykimit, pasi shqyrtoi aktet e ndodhura në fashikullin e mosfillimit, krijon bindjen se organi i akuzës, përveç një sërë veprimesh të nevojshme që ka kryer, nuk ka thirrur me cilësinë e dëshmitarit shtetasin ***, ***, për të dhënë deklaratimet e nevojshme në lidhje me akuzën e ngritur nga ana e kërkuarit ***, ***. Gjykata konstatoi se organi i akuzës nuk ka kryer një hetim të plotë dhe, për këtë arsye, vendimi duhet të kthehet pranë organit të Prokurorisë, për hetime të mëtejshme [...].

24.2.4 Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë **.4.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.*** akti, datë **.11.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, e cila, ndër të tjera, ka çmuar se: [...] pyetja e shtetasit ***, ***, është e domosdoshme për të bërë hetimin e plotë dhe të gjithanshëm. Në rastin kur hetohet vepra penale e mashtrimit, organi i procedurës duhet të hetojë faktin se përfituesi i të hollave ka qenë në një marrëdhënie ortakërie juridiko-civile, apo e gjithë kjo ka shërbyer si gënjeshtër për realizimin e qëllimit kriminal, që synon hedhjen në dorë në mënyrë të paligjshme të pasurisë së tjetrit [...].

24.2.5 Subjekti i rivlerësimit, më datë **.5.2018, ka nxjerrë urdhrin për regjistrimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale të “Mashtrimit”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal dhe, më datë **.2.2019, ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, emrin e shtetasit nën hetim ***, ***, për veprën penale të “Mashtrimit”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal.

24.2.6 Në përfundim të hetimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, në kuadër të procedimit penal, ka paraqitur para kësaj gjykate, kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes nr. ***/2018, në ngarkim të shtetasit ***, ***, për veprën penale të “Mashtrimit”, parashikuar nga neni 143 i K. Penal.

24.2.7 Në përfundim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me vendimin nr. ***, datë **.10.2022, ka vendosur: [...] Deklarimin fajtor të të pandehurit ***, ***, ***, për kryerjen e veprës penale të “Mashtrimit” dhe, në bazë të nenit 143/3, të Kodit Penal, dënimin e tij me 5 vite burgim [...].

24.3 Komisioni, nisur nga faktet që rezultojnë në dosje, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi duket se ka mangësi profesionale nga ana e subjektit në hetimin e kësaj çështjeje, për sa në vijim [...].

(1) Nga analiza e fashikullit ka rezultuar se, nga ana e organit të akuzës, me regjistrimin e kallëzimit penal nr. ***/2016, të shtetasit ***, ***, nuk janë kryer veprime procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit, duke arritur në konkluzionin se fakti i mësipërm nuk përben

*elemente të veprës penale, pasi kjo është një marrëdhënie juridike civile dhe, si e tillë, duhet të vendoset mosfillimi i procedimit penal nr. ***, të vitit 2016.*

(2) *Pasi gjykata e ka shqyrtuar çështjen, ka vendosur të anulojë vendimin e mosfillimit dhe e ka detyruar organin procedural të kryejë hetime. Gjykata ka konstatuar se organi i akuzës nuk ka kryer një hetim të plotë dhe, për këtë arsye, vendimi duhet të kthehet pranë këtij organi për hetime të mëtejshme [...].*

24.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar se ankuesi ka pretendime ndaj tij për korrupsion dhe mungesë profesionalizmi, edhe pse çështja penale e iniciuar nga denoncuesi është dërguar për gjykim dhe i pandehuri është deklaruar fajtor, sipas vullnetit të kallëzuesit ***. ***. Në lidhje me konstatimin e trupit gjykues të Komisionit, subjekti shpjegon se në momentet e para të verifikimit të materialit kallëzues të shtetasit ***. ***, i është krijuar përshtypja se fakti i kallëzuar nuk përmbante elemente të veprës penale, pasi ishte një marrëdhënie juridike-civile dhe, si e tillë, duhet të vendosej mosfillimi i procedimit penal. Natyrisht që ky vendim është marrë pa kryer asnjë veprim procedural, nisur edhe nga mënyra e paraqitjes së rrethanave të faktit nga ***. ***, në kallëzimin e tij. Pas vendimeve gjyqësore për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit janë kryer disa veprime hetimore dhe janë bërë përpjekje për të kontaktuar dhe marrë në pyetje shtetasin e kallëzuar ***. ***, përpjekje që kanë rezultuar pa sukses, edhe për shkak të qëndrimit të tij në Rumani.

